

FTESË PËR OFERTË

Kreditimi Rural i Kosovës (KRK) është institucion mikrofinanciar i cili me qëllim të zgjedhjes së kompanisë për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve për vitin 2019, fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertat e tyre për:

SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE

Kreditimi Rural i Kosovës ka gjithsej **65 vetura**, prej tyre 55 vetura të markës Volkswagen (Golf dhe Polo) dhe 1 veturë të markës Opel (viti 2000), 2 Skoda Octavia (viti 2017), 1 Seat Ibiza (viti 2005), dhe 6 vetura Seat Ibiza (viti 2018).

Veturat janë të bazuara në komunat e Kosovës siq vijon: Deçan, Ferizaj, Gjakova, Gjilan, Gillogoc, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malisheva, Mitrovicë, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suhareka, Viti, Vushtrri, Dragash dhe Kamenicë dhe dy degë të reja që do të hapen gjatë vitit 2019.

Ofertat për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve do të vlerësohen sipas kushteve dhe kriterëve të poshtëshënuara:

1. Çmimi me i volitshëm i pjesëve rezervë, dhe shërbimeve (çmimet duhet të jenë për njësi dhe në çmim të përfshihet TVSH),
2. Çmimi me i volitshëm për artikujt bazë
3. Aplikimi i zbritjes edhe në artikujt tjere për veturat përkatëse të cilat nuk janë pjesë e listës bazike
4. Prejardhja e pjesëve rezervë,
5. Eksperiencës së ofertuesit në punët e servisimit dhe mirëmbajtjes,
6. Garancioni për pjesët rezervë dhe shërbimet e ofruara,
7. Disponimi i aparaturës kompjuterike për diagnostifikim të defekteve të automjeteve.
8. Posedimi i serviseve në komunat apo afërsi të komunave ku janë të bazuara veturat e KRK-së.

Ofertuesit duhet të paraqesin ofertën (çmimet) e tyre sipas 'Listës bazike të pjesëve dhe punës' dhe poashtu të paraqesin çmimet apo zbritjen e çmimit për pjesët dhe punën që nuk janë përfshirë në 'Listën bazike të KRK-së'.

Lista bazike e KRK-së do të ju dërgohet ofertuesve të interesuar në bazë të kërkesës së tyre.

Kontrata me ofertuesin e sukseseshëm do të lidhet me afat një vjeçar me mundësi ripërtëritje.

Afati për paraqitjen e ofertave është nga data **28.11.2018** deri me datën **11. 12.2018 deri në orën 15:00**, në adresën e më poshtme: **Kreditimi Rural i Kosovës LLC / Rr. Behije Dashi, Nr.4 / 10000 Prishtinë** apo përmes email adresës **krk_imf@krk-ks.com**.